

FJALA E DEPUTETIT XHEMAL QEFALIA

E ENJTE 14 PRILL 2022

Të nderuar kolegë,

Akti ka kaluar dhe nuk ka më fuqi vepruese. Po si erdhi ky akt, që u miratua nga qeveria? Presidenti i Republikës, pasi ndenji 3 vjet pa nxjerrë dekret për datën e zgjedhjeve në Bashkinë e Shkodrës dhe disa bashki të tjera, pasi pa me optikë të zmadhuar se çfarë po ndodhte në oborrin e PD-së më 8 janar, më 20 janar u ul dhe vendosi të dekretojë 6 marsin si datë të zgjedhjeve të pjesshme vendore. Në fakt, ky akt i gjeti të papërgatitura subjektet politike, por domosdoshmëria e tij erdhi si nevojë imediate që qytetarët shqiptarë të kenë të drejtë të votojnë. Votuan rreth 150 mijë shtetas, nuk ishte numër i vogël. Të mendojmë për një moment sikur qeveria të mos e miratonte këtë akt. Llogaritarët e Partisë Demokratike do t'i konsideronin menjëherë vota të tyre dhe fitorja do të ishte spektakolare, por përgjegjësia dhe përgjegjshmëria e qeverisë shqiptare bëri të mundur nxjerrjen e aktit për t'u dhënë shtetasve mundësinë e votës. E falënderoj kolegen Çupi, sepse ishte ndër të vetmet anëtare të Partisë Demokratike që u mor pikërisht me aktin! Pjesa tjetër vazhdojnë të merren me çfarë t'u vijë në mendje, ndoshta me idenë për të hequr vëmendjen nga problemet që kanë.

E nderuar zonja kolege,

Qeveria e ka në konsideratë dhënien e mundësisë që shtetasit shqiptarë të pajisen me karta identiteti. Kjo është miratuar para 1 viti në këtë Kuvend, por ju nuk keni qenë, sepse keni pasur axhendë tjetër. Qeveria ka dhënë mundësinë e pajisjes së shtetasve shqiptarë me kartë, madje koncesionari është i detyruar ta japë në banesë këtë shërbim për individët me aftësi të kufizuara, që e kanë të pamundur lëvizjen. Gjithashtu, me ligj pensionistët mbi 75 vjeç nuk do të kenë nevojë ta ribëjnë kartën. Dikush mund të pyesë: pse 75 vjeç? Po, sepse 600 mijë është numri i pensionistëve. Megjithatë, unë jam kritik ndaj qeverisë për këtë rast dhe e sjell në vëmendjen tuaj, zoti Çuçi. Ne nuk duhet të presim zgjedhjet për të bërë akte, por është e detyrueshme që kartën ta ketë çdo qytetar që merr shërbim. Kanë kaluar 3 vjet dhe unë e di që ka qenë shumë e vështirë, pasi kartat merren në postë dhe për shkak të COVIDit ishte e ndaluar, por duhet të merren masa të tjera shtrënguese, me qëllim që shtetasit ta kenë kartën në çdo moment. Vitin tjetër do të zhvillohen zgjedhjet vendore dhe nuk do të jetë e udhës të nxjerrim një akt, ndërkohë që karta ka një afat 10-vjeçar.

Pra, afati i kartave të vitit 2019 përfundon në vitin 2029. Nuk jam me idenë e asaj kohe, që të sponsorizojë shteti për të bërë kartën, sepse me një matematikë të thjeshtë, për ta kuptuar qytetarët shqiptarë, karta kushton 15 mijë lekë të vjetër, që do të thotë për 10 vjet të kursejmë 150 lekë të rinj në vit dhe mund ta kemi kartën e identitetit. A ka gjë pozitive? Po, ka një gjë pozitive, që, siç me të drejtë e tha ministri, për herë të parë gjendja civile nuk atakohet nga OSBE-ja, nuk atakohen listat e zgjedhjeve. Pse kemi frikë ta themi këtë? Është realitet, është fakt që falë punës këmbëngulëse të kësaj ministrie, të kësaj drejtorie, është bërë e mundur të dalin listat. I mbani mend si i nxirrni listat tuaja? Tani nuk ka asnjë problem me gjendjen civile dhe kjo duhet pranuar. Pse nuk ju vjen mirë që themi se është

vendosur sistemi online? Nuk shkoni më për të mbajtur radhën për të marrë certifikatën. Thojeni edhe këtë! Përse keni frikë ta thoni?!

Është premtuar nga qeveria se do të fillojë edhe libri i adresave. Edhe kjo është një gjë shumë pozitive, pranojeni; pranojeni si një fakt! Madje, ju këtu duhet të diskutoni që jo vetëm të pajisen me karta, por të mendohet kërkesa që kjo maxhorancë e ka bërë vazhdimisht me dije, që të pajisen me kartë edhe emigrantët, që nesër të jenë të gatshëm të votojnë, të kenë edhe ata të drejtën e tyre. Ashtu siç sjellin të ardhura këtu nga ekonomitë e tyre, të vendosin edhe për ligjvënësin shqiptar. Zoti Ministër, unë mendoj se kjo duhet të jetë e udhës dhe e jap edhe si një sugjerim për ju, për t'u menduar edhe një herë për votimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Që ata të bëhen gati për të votuar, duhet të pajisen detyrimisht njësoj si të gjithë shtetasit shqiptarë. Opozita e ka votuar nëpër komisione, sepse është një akt që tashmë ka kaluar dhe nuk ka më fuqi, dhe besoj se do ta votojë sërish, për të krijuar idenë që (atë që ka shprehur me të drejtë Gjykata Kushtetuese) prania e nevojës dhe urgjencës e ka detyruar qeverinë shqiptare ta nxirrte këtë akt. Faleminderit!